

“Arberia” sh.a.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

(të Ushtrimit të mbyllur më datë 31.12.2019)

18 Qershor 2020

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Arberia” sha

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

1. Informacion i përgjithshëm.

Arberia sha është Shoqëri anonime themeluar me vendim të Gjykatës nr. 12639, dt 21.08.1995 me aksionere:

- Pellumb Mustafaj me perqindje te pjesmarrjes 97.53,
- Ali Muskaj me perqindje te pjesmarrjes 1.47,
- Bashkim Hajro me perqindje te pjesmarrjes 0.97.

Shoqeria eshte regjistruar ne Drejtorine Rajonale Tatimore, Fier me nipt J62903522G. Veprimtaria e shoqerise rregullohet sipas dispozitave te Ligjit Nr.9901, dt.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar, nga statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Selia e shoqërisë është në Mbrostar Ura, Fier.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise “Arberia” sha eshte: Ndertime, rikonstruksione, projektme te te gjitha fushave dhe llojeve, veprimtari industriale tregtare, investime, veprimtari eksport-impot etj.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi


Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të



A handwritten signature in black ink is written over a circular stamp. The stamp contains the text "ARBERIA SH.A." in the center, "FIER - ALBANIA" around the bottom edge, and a small star symbol at the bottom center.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Arberia” sha

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël


Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

1. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

1.1 Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Arberia” sha

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/ LEK	108.64	107.82

1.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme


Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Arberia” sha

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

1.3 Inventarët


Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

1.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendosjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në Ndërtim në



ARBERIA
SH.A.
FIER - ALBANIA

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Arberia” sha

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

proçes” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertesa	Vlere e mbetur	5%
Makineri e pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Paj, zyre e informat	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi


Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shirja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjata të investuara dhe



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Arberia” sha

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t’u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t’u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).


Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat priten të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshem në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Arberia” sha

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Postet e bilancit paraqiten:

Aktive monetare per 38.486.398 leke, paraqesin mjete monetare ne banke.


Shoqeria operon me disa banka, te gjitha veprimet jane rregjistruar ne ditaret perkates, me llogarite ne valute veprimet jane kryer me kursin ditor te bankes, ndersa gjendja e monedhave te huaja ne fund te ushtrimit eshte vleresuar me kursin e Bankes se Shqiperise me date 31.12.2019 duke kaluar sipas rastiit ne llogarite e shpenzimeve apo te ardhurave diferencat e kembimit.

Te drejta te arketueshme në vlerën 20.101.816 leke perfaqesojne:

Nga aktiviteti i shfrytezimit ne shumen 11.033.963 leke, paraqet llogarine Kliente per vleren e faturave te paarketuara. Kjo llogari eshte e analizuar sipas klienteve dhe rakordon me llogarine sintetike te tyre.

Te tjera te drejta per 9.067.853 leke paraqet:

- ***Tatim Fitimi*** per 1.269.400 leke.
- ***te tjera te drejta*** ne shumen 7.798.453 leke paraqet detyrim te te treteve ndaj shoqerise.



The image shows a handwritten signature in black ink over a circular stamp. The stamp contains the text "ARBERIA S.H.A." in the center, "FIER - ALBANIA" at the bottom, and "RISE" at the top. There are also some smaller, less legible characters around the perimeter of the stamp.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Arberia” sha

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Ne llogarine *Lende te para e materiale te konsumueshme* ne shumen 5.521.412 lekë, shoqëria ka paraqitur gjendjen e materialeve më datë 31.12.2019.

Stoku evidentohet në llogari sipas metodës me inventar të perhershëm. Ato justifikohen me dokumenta dhe janë regjistruar në shpenzime me koston e marrjes. Inventari fizik i gjendjes se materialeve eshte kryer nga shoqëria ne fund te ushtrimit i cili rakordon me gjendjen e paraqitur ne bilanc.

Aktive afatgjata materiale

Shoqëria ka një vlerë neto aktivesh afatgjata materiale per 5.614.594 lekë.

	<i>Viti 2019</i>	<i>Viti 2018</i>
Toka	3.152.000	3.152.000
Ndert. e instalime te pergjithshme	826.343	869.835
Makineri, Pajisje	517.314	4.600.574
Mjete transporti	1.118.937	2.571.250
Pajisje zyre dhe informatike	0	599.000
Totali	5.614.594	11.792.659

Amortizimi i llogaritur per 2019 eshte 452.554 leke. Gjate 2016 jane shitur aam me vlere te mbetur 5.725.511 leke. Aam justifikohen me inventar fizik te kryer ne fund te ushtrimit.

DETYRIMET DHE KAPITALI

Kapitalet e veta paraqiten me vlerë 3.723.261 lekë.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë eshte 8.527.000 leke i barabarte me ekstraktin historik.

Rezerva ligjore paraqitet ne vleren 2.305.083 leke, e pandryshuar nga viti kaluar.


Rezerva te tjera ne shumen 183.620 leke eshte pakesuar ne shumen 45.021.118 leke e cila se bashku me fitimin e vitit 2018 ne shumen 1.728.882 leke, ne total 46.750.000 leke eshte shperndare si dividend sipas vendimeve te asamblese se aksionereve date 30.03.2019 leke 18.750.000 dhe 18.06.2019 leke 28.000.000.

Humbje ushtrimit sipas bilancit kontabël paraqitet per 7.292.442 leke.

Detyrimet

Detyrimet me vlerë 66.000.959 lekë përfaqësojnë:

	<i>Viti 2019</i>	<i>Viti 2018</i>
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	51.956.859	60.847.539



A handwritten signature in black ink is written over a circular stamp. The stamp contains the text 'ARBERIA' and 'S.A.' around the perimeter, with 'ERISE' at the top. The signature is a cursive scribble.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Arberia” sha

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore	13.651.950	14.900.756
Detyrimet tatimore	392.150	189.013
Totali	66.000.959	75.937.308

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit per 51.956.859 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara, kjo llogari është e analizuar sipas furnitoreve dhe rakordon me llogarinë sintetike të tyre. Ne pasqyrat financiare detyrimi eshte i ndare nen nje viti dhe mbi nje vit.

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore paraqitet detyrimi i shoqerise per pagat e punonjesve ne shumen 13.608.426 leke dhe detyrim ndaj sigurimeve per muajin dhjetor 2019 ne shumen 43.524 leke.

Detyrimet tatimore paraqesin:

1. **Tvsh** per 390.850 leke,
2. **Tatim page** ne shumen 1.300 leke.

Verifikimi i llogarise Fitime Humbje

Shpenzimet dhe të ardhurat janë grupuar si më poshtë:

	Viti 2019	Viti 2018
Te ardhura		
Nga shitja e mallrave e sherbimeve	14.717.643	33.364.135
Te ardhura te tjera	589.458	
Totali (Afarizmi)	15.307.101	33.364.135
Materiale te konsumuara	10.809.497	9.378.199
Kosto e punes	4.151.198	8.994.150
Pagat e personelit	3.557.153	7.707.920
Shpenzimet per sigurime	594.045	1.286.230
Amortizimi	452.554	1.988.486
Shpenzime te tjera	7.062.435	11.293.193
Totali i shpenzimeve	22.475.684	31.654.028
Te ardhura nga interesat	27.702	15.884
Te ardhura nga kursi kembimit	-151.561	379.393
Te ardhura te tjera		
Fitimi Bruto	-7.292.442	2.105.384
Tatim fitimi		376.502
Fitimi Neto (bilanci)	-7.292.442	1.728.882



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Arberia” sha

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Shpenzimet jane 22.627.245 leke, ndersa te ardhurat 15.334.803 lekë. Rezultati neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj gjate ketij viti ushtrimor është humbje 7.292.442 leke.

Te ardhurat e realizuara gjate ushtrimit perfaqesojne te ardhura nga shitja e punimeve 5.870.077 leke, te ardhura nga shitja e mallrave 8.847.566 leke, te ardhura nga shitja e aam-ve ne shumen 589.458 leke. Ne te ardhurat perfshihen edhe te ardhurat nga interesat ne vlere 27.702 leke.

Shpenzimet per 22.627.245 lekë, jane te justifikuara me dokumenta te rregullta fiskale. Më konkretisht shpenzimet sipas zërave paraqiten:

Shpenzimet per materiale jane 10.809.497 lekë, ato janë përdorur për veprimtarinë kryesore të shoqërisë, këto shpenzime janë të justifikuara me dokumenta.

Personeli, në këtë llogari janë pasqyruar shpenzimet për paga 3.557.153 lekë, sigurime shoqërore 594.045 lekë, listëpagesat janë përpiluar saktë dhe shpenzimet për paga e sigurime janë vendosur korrekt në këtë llogari. Nje permbledhese e pagave paraqitet :

muajt	paga	paga	punedhesi	punemarra si	sig shend	nr	paga bruto	tatim page
janar	600,000	600,000	90,000	57,000	20,400	19	600,000	3,900
shkurt	600,000	600,000	90,000	57,000	20,400	19	600,000	3,900
mars	511,538	511,538	76,730	48,596	17,393	19	511,538	1,300
prill	319,230	319,230	47,884	30,326	10,854	12	319,230	1,300
maj	310,000	310,000	46,500	29,450	10,540	10	310,000	1,300
qershor	200,385	200,385	30,060	19,035	6,815	10	200,385	1,300
korrik	160,000	160,000	24,000	15,200	5,440	5	160,000	1,300
gusht	160,000	160,000	24,000	15,200	5,440	5	160,000	1,300
shtator	172,000	172,000	25,800	16,340	5,848	7	172,000	1,300
tetor	212,000	212,000	31,800	20,140	7,208	7	212,000	1,300
nentor	156,000	156,000	23,400	14,820	5,304	5	156,000	1,300
dhjetor	156,000	156,000	23,400	14,820	5,304	5	156,000	1,300
totali	3,557,153	3,557,153	533,574	337,927	120,946	10	3,557,153	20,800

Amortizimi ne shumen 452.554 leke.

Shpenzime te tjera per 7.062.435 leke paraqesin:

- Shpenzime transporti dhe karburanti 750.000 leke,
- shpenzime kontabiliteti e auditimi 132.500 leke,
- shpenzime komisione banke 35.322 leke,
- shpenzime taksa 216.958 leke,
- shpenzime mirembajtje 52.000 leke,
- shpenzime siguracioni ne shumen 4.059 leke,
- shpenziome gjoba ne shumen 146.085 leke,
- vlere e mbetur e aam-ve te shitura 5.725.511 leke.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Arberia” sha

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Shpenzime financiare ne shumen 151.561 leke paraqet diferenca negative kembimi.

Rezultati ushtrimor neto qe shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj është humbje 7.292.442 leke.

Administratori
Pellumb Mustafa

